



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSA" VLORE

VENDIM

Nr. 3 Dt. 22-08-2013

Per miratim ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te bregut te detit Jon, ne zonen e Himares, ne tunelin e Nendeteseve ne Porto Palermo dhe te marines Porto Palermo, duke shfrytezuar siperfaqen ujore te tij, per ndertim port jahtesh, subjektit "AMZ" sh.p.k, me administrator Z. Edmond Zhupani.

Ne zbatim te Ligjit Nr.8093 Dt.21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt.18.12.2006 "Per koncesionet", kreu IV, te Vendimit te K.M-ve nr. 27, dt. 19.01.2007, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve", kreu II, te vendimit te K.K.U-it, nr.3, dt. 19.07.2002 "Per miratimin e rregullores te Sekretariatit Teknik, te K.K.U-it, te K.B.U-es dhe A.U. - it", si dhe udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E, K.B.U "Vjose":

VENDOSI:

1. **Te Miratohet ne parim kerkesa**, per dhenien me koncension, te bregut te detit Jon, ne zonen e Himares, ne tunelin e Nendeteseve ne Porto Palermo dhe te marines Porto Palermo, duke shfrytezuar siperfaqen ujore te tij, per ndertim port jahtesh, subjektit "AMZ" sh.p.k, me administrator Z. Edmond Zhupani.
- 2- Vendi, ku parashikohet te ndertohet Porti i Jahteve "Marina Porto Palermo" eshte ne Himare , ne tunelin e Nendeteseve ne Porto Palermo dhe te marines Porto Palermo.
- 3- Siperfaqja ujore qe parashikohet te zere ndertimi i portit te jahteve, do te jete 235 000m².

• **Vazhdim i Projekt - Vendimit Nr. , Dt. . 2013.**


4- Subjekti “AMZ”sh.p.k, do ti nenshtrohet procedurave te konkurimit, sipas kerkesave te ligjit nr. 9663, dt.18.12.2006 “Per koncesionet” dhe vendimit nr. 27, dt. 19.01.2007, “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve”, kreut III-pika 1 “Per propozimet e kerkuara”.

5 - Subjekti “AMZ” sh.p.k, te paraqitet prane autoritetit kontraktues dhe njesise te trajtimit te koncesioneve, per vazhdimin e procedurave.

6- Ngarkohet A.U.B “Vjose” per zbatimin e ketij vendimi.

7- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJES I A.U.B “VJOSE”
Ardian DINE



KRYETARI I K.B.U “VJOSE”
Eduart VELCANI

